

Vendim nr. 134, datë 28.04.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 28.04.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (L) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: LULZIM KURTI, përfaqësuar nga avokatët Faslli Çekaj dhe Klodian Çobo, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2022-3668) 500, datë 22.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2022-1948 (309), datë 20.12.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2025-1298, datë 24.07.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 2, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, dhe 148/b, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 49, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi i materialeve të ardhura bashkë me kërkesën rezulton se ndaj kërkuesit ka bërë kallëzim penal shtetasja E.K., e cila është njëkohësisht edhe bashkëshortja e tij, duke pretenduar se ai (kërkuesi) ka abuzuar seksualisht me vajzën e saj nga martesë e parë, shtetasen e mitur R.S. Në kallëzimin e saj shtetasja E.K. ka shpjeguar se jeton në një banesë së bashku me bashkëshortin, vajzën e saj 14-vjeçare R.S. nga martesë e parë, si dhe dy fëmijët e tjerë të mitur, të moshës 7 dhe 4 vjeç, të cilët i ka me kërkuesin. Për këtë arsye, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 27.01.2021, është paraqitur kërkesa për gjykim ndaj kërkuesit, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, të parashikuar nga neni 100, paragrafi i dytë, i Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2022-3668) 500, datë 22.07.2022, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale, për të cilën është akuzuar, dhe dënimin e tij me 28 (njëzetë e tetë) vjet burgim. Sipas asaj gjykate, është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi i ka konsumuar nga ana objektive elementet e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, të parashikuar nga neni 100, paragrafi i dytë, i KP-së dhe rezulton se këtë veprë penale ai e ka kryer më shumë se një herë, në kohën kur viktimë nuk kishte mbushur moshën 14 vjeç dhe nuk kishte arritur pjekurinë seksuale. Po sipas gjykatës së shkallës së parë, ky fakt provohet me deklarinimet e viktimës së mitur të veprës penale, e cila është shprehur se ngacmimi seksual nga njerku i saj kishte nisur vitin kur lindi vëllai i saj, gjatë kohës që e ëma përkujdesej për vëllain. Po sipas asaj gjykate, fakti penal provohet nga deklarinimet e viktimës së mitur të veprës penale, që janë vlerësuar dhe nga psikologjia e caktuar gjatë hetimeve paraprake të përshkruara në aktin e ekspertimit, nga incizimet e gjendura në telefonin celular të kërkuesit, dëshmisë së prindërve të së ëmës së viktimës, të cilat janë në përputhje me provat e tjera shkencore, si dhe nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. 412/D, datë 28.09.2020. Ndërsa për masën e caktimit të dënimit gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në rastin e kërkuesit konstatohen rrethana rënduese nga ato të parashikuara nga neni 50, shkronjat “e” dhe “g”, të KP-së. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2022-1948 (309), datë 20.12.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. (11-2022-3668) 500, datë 22.07.2022 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës. Sipas gjykatës së apelit, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe është marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe çmuarjes së drejtë të provave të administruara gjatë gjykimit dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi. Po sipas gjykatës së apelit, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Lulzim Kurti i ka konsumuar nga ana objektive

elementet e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, të parashikuar nga neni 100, paragrafi i dytë, i KP-së dhe ky fakt provohet me deklaratimet e viktimës së mitur të veprës penale, e cila është shprehur se ngacmimi seksual nga njerku i saj ka nisur në vitin kur lindi vëllai i saj, gjatë kohës që e ëma përkujdesej për vëllain, nga incizimi i gjendur në telefonin celular të kërkuesit, dëshmisë së prindërve të së ëmës së viktimës, të cilat janë në përputhje me provat e tjera shkencore, si dhe nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2025-1298, datë 24.07.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP). Sipas Kolegjit Penal, rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk e cenon vendimmarrjen e gjykatës së apelit, i cili është një vendim i marrë në interpretim e zbatim të drejtë të ligjit. Për sa i përket dëshmisë së viktimës së veprës, Kolegji Penal ka vlerësuar se ajo është marrë në mënyrën e duhur procedurale, në prani edhe të psikologes. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se edhe deklaratimet e nënës së viktimës rezultojnë koherente dhe jo që të kenë përplasje ose kundërtënie lidhur me faktet në dijeni të saj. Për këto arsye, Kolegji Penal ka vlerësuar se fajësia e kërkuesit për kryerjen e veprës penale, për të cilën është akuzuar, është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe vërtetimi i fajësisë së tij është bërë në respektim të parashikimeve të neneve 149 e vijues të KPP-së, veçanërisht parashikimeve të nenit 152 të KPP-së. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, gjykatat kanë analizuar të gjitha provat në tërësi, pa mbivlerësuar a nënvlerësuar ndonjërin prej tyre. Po sipas atij kolegji, pas shqyrtimit të provave në tërësi, gjykatat kanë çmuar vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku janë mbështetur për të krijuar bindjen e për fajësinë e kërkuesit. Në përfundim, Kolegji Penal ka arsyetuar se të dhënat e përfuara nga provat e analizuar janë në harmoni me njëra-tjetrën, duke u arritur në përfundim të pacenueshëm mbi fajësinë e të gjykuarit dhe kjo analizë vlerësohet nga kolegji si e plotë, ezauruese, në interpretim e zbatim të drejtë të ligjit.

5. Në datën 17.02.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5, të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 27.02.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se:

- 6.1. Është cenuar *e drejta e aksesit*, pasi kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për t'u dëgjuar në seancë, si dhe prova e fakte të tjera për të mbështetur pretendimet e tij, por Kolegji Penal i asaj gjykate e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve.
- 6.2. Është cenuar *standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk i përmbush kriteret kushtetuese për arsyetimin e tij, për shkak se nuk janë arsyetuar shkaqet e mospranimit. Ai kolegji nuk është shprehur për shkeljet e ligjit material dhe procedural, sipas pretendimeve të paraqitura në rekurs nga kërkuesi.
- 6.3. Është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi Gjykata e Lartë ka përdorur në mënyrë të gabuar barrën e provës. Kjo e fundit i kërkohet organit të akuzës dhe jo të akuzuarit. Gjykatat kanë marrë si të vërteta thëniet e nënës dhe të vajzës së saj, bazuar në një incizim të bërë me telefon, i cili është vërtetuar shkencërisht se është i pasaktë. Nga gjykatat janë pranuar vetëm në provat që ka sjellë nëna e “viktimit”.
- 6.4. Gjykatat kanë gabuar në kualifikimin e veprës penale dhe kanë mënjanuar analizën juridike të provave shkencore. Po kështu, gjykatat kanë shkelur praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës. Akuza ndaj kërkuesit nuk është vërtetuar në prova të pakundërshtueshme. Gjykatat kanë gabuar në vlerësimin e provave, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka pranuar provat e paraqitura nga kërkuesi me shtesën e rekursit. Regjistrimi në celularin e kërkuesit nuk është kryer prej tij dhe fotot që pretendohet se janë bërë nga ai, gjithashtu, nuk rezultojnë të jenë bërë prej tij, por nga bashkëshortja e tij. Kompjuteri i kërkuesit nuk është ekzaminuar nga ekspertë të fushës. Mungojnë elementet e bashkëpunimit ose të dhunës, si dhe fakti i kryerjes së veprës “më shumë se një herë”, ose i pasojave të rënda për shëndetin e viktimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues

individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, Kolegji evidenton se mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e çështjes në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sipas neneve 42 dhe 142 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, në drejtim të së drejtës së aksesit, *standardit të arsyetimit të vendimit dhe parimit të prezumimit të pafajësisë*.

10. Për sa i përket së drejtës së aksesit, sipas kërkuesit, kjo e drejtë është për shkak se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, edhe pse ai ka paraqitur kërkesë në atë gjykatë për t'u dëgjuar në seancë.

11. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 27, datë 29.05.2025; nr. 5, datë 29.01.2025; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar si element përbërës të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën për t'u dëgjuar, e cila, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor, ku individëve u krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjojnë realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar,

individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, Gjykata është shprehur se kjo e fundit ka detyrimin t'u sigurojë palëve mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve (*shih vendimin nr.17, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Kurse në lidhje me formën e gjykimit, Gjykata është shprehur se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë në seancë në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk pengon debatin mes palëve në kuadër të së drejtës për t'u dëgjuar, i cili realizohet njësoj, pavarësisht formës së paraqitjes së argumenteve me shkrim dhe shkëmbimit respektiv e në kohën e duhur të parashtrimeve (*shih vendimet nr. 26, datë 09.04.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, në referim të dispozitave që rregullojnë rekursin në Gjykatën e Lartë, shqyrtimi në këtë gjykatë kalon në një ose në dy faza. Në fazën e parë, e cila njihet edhe si faza seleksionuese, neni 433 i KPP-së parashikon shqyrtimin e rekursit në lidhje me kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit, ku në mungesë të ekzistencës të të cilave Gjykata e Lartë disponon për mospranimin e tij, duke i dhënë kështu fund shqyrtimit gjyqësor. Ndërkohë, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, në fazën e dytë çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve (neni 436/a i KPP-së) ose në prani të palëve në raste përjashtimore, të parashikuara nga neni 437, pika 1, i KPP-së.

14. Nga sa më lart, për sa i përket pretendimit se çështja duhej të ishte shqyrtuar në seancë gjyqësore, Kolegji vëren se, më së pari, kjo është një çështje e mënyrës së zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, e cila është ajo që vlerëson nëse në një çështje të caktuar ekziston ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 437, pika 1, i KPP-së për shqyrtimin e saj në seancë gjyqësore në prani të palëve. Nga ana tjetër, forma e gjykimit e ndjekur në rastin konkret, në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, nuk duket të ketë ndikuar në të drejtat e kërkuarit, për sa kohë ai i ka pasur të gjitha mundësitë të ushtrojë të drejtën e mbrojtjes të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, qoftë nëpërmjet paraqitjes së rekursit, ashtu edhe përmes paraqitjes së parashtrimeve të tij përpara seancës ose shtesës së rekursit.

15. Në këtë kuptim, Kolegji evidenton se vetëm mënyra e zhvillimit të seancës gjyqësore, pa praninë fizike të palëve, nuk vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt, për sa kohë që shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji dhe nuk është provuar që çështja e kërkuarit të përfshihet në ato raste që

sipas nenit 437 të KPP-së kërkojnë gjykimin në seancë gjyqësore me praninë fizike të palëve. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit është haptazi i pabazuar.

16. Në lidhje me *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, kërkuari ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk përmbush kriteret kushtetuese për arsytimin e tij, për shkak se nuk janë arsyetuar shkaqet e mospranimit. Po sipas kërkuarit, ai kolegji nuk është shprehur për shkeljet e ligjit material dhe procedural, sipas pretendimeve të paraqitura në rekurs nga ai.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se arsytimi i vendimit është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se ai (vendimi gjyqësor), në çdo rast, duhet të jetë i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsytim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqësore, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 24, datë 09.04.2024; nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Po në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Arsytimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, duke iu referuar arsytimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, Kolegji konstaton se vendimi i atij kolegji përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsytimin e tij, pasi ka arsyetuar shkaqet se përse rekursi i kërkuarit nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 432 i KPP-së. Po ashtu, rezulton se ai kolegji i ka dhënë përgjigje në thelb pretendimeve të kërkuarit të ngritura në rekurs, duke e vlerësuar të drejtë vendimmarrjen e gjykatës së apelit dhe vendimi i tij nuk

është jokohërent ose që të ketë kundërthënje ose kontradiksion, ndërkohë që pjesët arsyetuese janë të mjaftueshme për të mbështetur ato që janë vendosur në pjesën urdhëruese. Ai vendim nuk rezulton të jetë alogjik dhe të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

19. Ndërsa lidhur me cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka përdorur në mënyrë të gabuar barrën e provës, pasi kjo e fundit i kërkohet organit të akuzës dhe jo të akuzuarit. Sipas kërkuesit, gjykatat i kanë marrë si të vërteta thëniet e nënës dhe të vajzës së saj, bazuar në një incizim të bërë me telefon, i cili është vërtetuar shkencërisht se është i pasaktë. Po sipas kërkuesit, nga gjykatat janë pranuar vetëm provat që ka sjellë nëna e “viktimës”.

20. Gjykata ka theksuar se, në rastin e gjykimit penal, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme dhe të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ato gjykata kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk u kanë dhënë prioritet provave të paraqitura nga organi i akuzës, nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Po kështu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji vëren se gjykatat nuk i kanë marrë të mirëqena thëniet e nënës dhe të vajzës së saj, por vendimet e tyre i kanë bazuar në provat e administruara në gjykim, të cilat i kanë vlerësuar në raport me njëra-tjetrën, duke i dhënë mundësinë kërkuesit që, në kushte të barabarta me organin e akuzës, të parashtrojë pretendimet dhe të kundërshtojë akuzat e ngritura ndaj tij, dhe provat mbi të cilat janë ngritur akuzat, të

paraqesë prova dhe të debatojë për to. Gjykatat kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, pa i dhënë ndonjëherë prej provave të shqyrtuara vlerë të paracaktuar. Ato gjykata kanë arritur në përfundimin për fajësinë e kërkuesit, pasi kanë kryer një proces të shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të administruara në gjykim, siç janë deklaratimet e viktimës së mitur të veprës penale, incizimet e gjendura në telefonin celular të kërkuesit, dëshmisë së prindërve të së ëmës së viktimës, si dhe aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, duke mos arritur në një konkluzion *apriori* për fajësinë e tij dhe duke e përcaktuar atë tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe arsyetuar mjaftueshëm në këtë drejtim. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

22. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se vlerësimi provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si dhe të vlerësimit të provave dhe fakteve, që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga sa më lart, referuar pretendimeve të tjera kërkuesit të paraqitura në ankimin kushtetues individual të tij, Kolegji konstaton se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e vlerësimit të provave dhe interpretimit të ligjit, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kërkuesi nuk ka sjellë asnjë argument konkret kushtetues për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në këtë drejtim. Në lidhje me këto pretendime të tjera të tij, në kushtet që kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë cenimin e të drejtave kushtetuese për shkak të mënyrës sesi kanë vepruar gjykatat në zgjidhjen e çështjes konkrete, ato (pretendimet) mbeten me natyrë të pastër ligjore, ndaj nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimet e tjera të tij paraqitura në ankimin kushtetues individual.

24. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji evidenton se nuk është i nevojshëm analizimi i mëtejshëm i plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues individual të kërkuarit.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.